



Narcotics Anonymous

Vërtet shërohem

Kur në fund të rrugës zbulojmë se nuk mund të funksionojmë më si qenie njerëzore, me ose pa droga, përballemi të gjithë me të njëjtën dilemë. Çfarë na mbetet të bëjmë? Ose vazhdojmë deri në fundin fatal — burgje, institucione ose vdekje — ose gjejmë një mënyrë të re jetese. Dikur, shumë pak të varur e kishin këtë mundësi të dytë. Të varurit sot janë më me fat. Për herë të parë në historinë e njerëzimit, një mënyrë e thjeshtë po dëshmohet efektive në jetën e shumë të varurve. Është e disponueshme për të gjithë. Është një program i thjeshtë shpirtëror — jo fetar — i njohur si Narkomanët Anonimë.